



A.nr.306/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.306/2026, të datës 16.03.2026, të parashtruar nga ankuesi G.D nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshill dhe votim të datës 07.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.306/2026, e datës 16.03.2026, e parashtruar nga ankuesi G.D.

A r s y e t i m

Ankuesi G.D (*tutje referuar ankuesi*), më datë 06.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit ndaj kërkesës së datës 12.01.2026.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit, ndërsa, kjo e fundit ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 306/2026 të datës 16.03.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesit e datës 24.03.2023 e parashtruar tek Komisioni për vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike; Emailin e datës 13.03.2023 nga SSHIKRS për A.D, E.P dhe V.H; Pyetësorin për identifikimin e sistemeve shtetërore të Insuficionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike nga ZKM; Emailin e datës 24.03.2023 nga Personeli IE për SSHIKRS; Kërkesën e datës 12.01.2026 të ankuesit; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 24.03.2026; Akt

Emërimin e datës 10.06.2014; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun/Web faqe.

Kolegji bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, **sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 1157-2-2014, të datës 10.06.2014, ushtron pozitën Zyrtar i Lartë për Komunikim dhe Informim/web faqe në Zyrën e Kryeministrit.
- Ankuesi përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, më datë 24.03.2023, ka dërguar tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, kërkesën për vlerësimin e sistemeve shtetërore, respektivisht përmes kësaj kërkeje është kërkuar njohja e sistemit Sistemi Informimit/Web Faqes, duke propozuar përfshirjen në Listën e ekspertëve pozitën e ankuesit sipas Klasës B6, mirëpo, ky sistem përmes raporti të parë të Komisionit kompetent ia provuar më Vendimin Nr. 23/165 të d 12.10.2023, të Qeverisë së Kosovës, nuk është miratuar si sistem më rendësi strategjie e mbi këtë bazë as pozita e ankuesit nuk është njohur si pozitë e ekspertit.
- Ankuesi serish më datë 12.01.2026, ka përgatitur kërkesë për Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, duke kërkuar fillimisht e njëjta të aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me qëllim që të kategorizohet në listën e Ekspertëve, mirëpo, e njëjta nuk është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kërkesën për përfshirje në listën e ekspertëve e ka pasur të aprovuar nga Zyrtari Kryesor Administrative, dhe të njëjtën e ka deleguar tek komisioni përkatës mirëpo nuk ka pranuar vendim për aprovim apo refuzim, ndërsa ndërlidhur me kërkesën e datës 12.01.2026, e njëjta nuk është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nuk është përcjell tek komisioni përkatës, e rrjedhimisht ka heshtje administrative në këtë drejtim. Kërkon që të obligohet Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së që të shqyrtoj kërkesën e datës 12.01.2026, të urdhëroj nxjerrjen e aktit administrativ të arsyetuar, të njihet e drejta e rimbursimit dhe pagesave retroaktive nga data 16.10.2023 apo nga vendimi i pasur i Qeverisë.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të themelësisë dhe bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2, paragrafi 1: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenit 14, paragrafi 3: 3.*

Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nisur nga objekti i ankesës thekson faktin se më hyrjen në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Qeveria e Kosovës më datë 05.02.2025 ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertë në fuqi nga data 06.02.2023 deri me 26.08.2024, më të cilën akt juridik janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, Qeveria e Kosovës duke u bazuar në nenin 6 të kësaj rregullore më Vendimin Nr.07/132, të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike (tutje SHHIKS) i cili komision ka nxjerrë dy raporte lidhur me njohjen e SHHIKS dhe listën e eksperteve të miratuara sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 dhe Vendimit Nr. 09/216, të datës 14.08.2024.

Tutje, Qeveria e Kosovës më datë 27.08.2024 ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertët, më të cilën është shfuqizuar Rregullorja (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertë, ndërsa, më Vendimin 10/230 të datës 13.11.2024, të Qeverisë së Kosovës është themeluar Komisioni i ri për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ndërsa, më Vendimin 09/230 të datës 13.11.2024, të Qeverisë së Kosovës është themeluar Komisioni për Ekspert përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave tjera të dërguara nga Zyrtarët Kryesor Administrativ të Institucioneve sipas Rregullores Nr. 22/2024 për Ekspertët.

Kolegji për trajtim të drejtë të ankesës iu referuar Kapitullit II të Rregullores (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertë, procedura për përcaktimin e ekspertëve për pozitat e tjera të përcaktuara në shtojcën 14.4. të ligjit të pagave, me theks të veçantë:

-Nëit 4Kriteret për vlerësimin e sistemeve 1. *Sistemet do të vlerësohen si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, nëse plotësojnë të paktën një prej kriterëve të mëposhtme: 1.1. përbëjnë infrastrukturë kritike të informacionit që përfshin sistemet ose funksionet, paaftësi ose shkatërrimi i të cilave do të mund të cenonte sigurinë kombëtare, qeverisjen, ekonominë ose mirëqenien sociale të vendit; 1.2. janë të natyrës së tillë që mundësojnë realizimin e funksioneve themelore shtetërore si në vijim: 1.2.1. regjistrimi civil dhe ai i automjeteve; 1.2.2. tatimet; 1.2.3. dogana; 1.2.4. buxheti dhe financat, përfshirë thesarin; 1.2.5. prokurimi publik; 1.2.6. shëndetësia; 1.2.7. pensionet dhe mirëqenia sociale; 1.2.8. edukimi dhe arsimi; 1.2.9. siguria, rendi dhe ligji; 1.2.10. drejtësia; 1.2.11. siguria kibernetike, siguria e rrjetit qeveritar, të dhënave dhe të qasjes në sisteme kompjuterike qeveritare; 1.2.12. mbrojtja; 1.2.13. zgjedhjet; 1.2.14. vizat; 1.2.15. regjistrimi i bizneseve; 1.2.16. regjistrimi i OJQ-ve; 1.2.17. regjistrimi i adresave dhe kadastrit; 1.2.18. informacioni gjeografik; 1.2.19. monitorimin e kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, monitorim të spektrit dhe për menaxhimin e resurseve frekuencore; 1.3. sistemet lidhen me menaxhimin e proceseve në administratën publike, konkretisht menaxhimin e burimeve njerëzore, postës elektronike zyrtare shtetërore, menaxhimin*

e pasurisë shtetërore dhe menaxhimin e arkivimit elektronik të dokumenteve; 1.4. sistemet shërbejnë për funksionet qendrore të qeverisjes elektronike; 1.5. qendrat shtetërore të të dhënave; 1.6. rrjetet shtetërore të të dhënave...

- Nenit 5 Kërkesa për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike 1. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit i cili vlerëson se institucioni është pronar, menaxhon dhe administron sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, ose koordinon funksionimin e këtyre sistemeve, parashtron kërkesë për vlerësim të sistemit tek Komisioni. 2. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përmbajë: 2.1. informacionin për nivelin e klasifikimit të sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.2. kategorinë e shërbimeve që ofron sistemi përkatës, të cilat mund të jenë si vijon: 2.2.1. përshkrimin e të dhënave që përmban sistemi përkatës; 2.2.2. ndikimin e sistemit përkatës të rrjetit dhe informacionit në realizimin e objektivave të institucioneve shtetërore; 2.2.3. ndikimin e sistemit përkatës të rrjetit dhe informacionit në realizimin e obligimeve ligjore të institucionit kërkues dhe institucioneve të tjera shtetërore; 2.2.4. ndikimin e sistemit përkatës të rrjetit dhe informacionit në realizimin e shërbimeve esenciale. 2.3. vlerësimin lidhur me rrezikimin e sistemit nga sulmet e mundshme kibernetike; 2.4. funksionet menaxhuese/koordinuese dhe shkallën e njohurive të specializuara që kërkohen për menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.5. sa është unik në nivel shtetëror secili sistem përkatës i rrjetit dhe informacionit, dhe ofrohen shërbime të ngjashme edhe nga sisteme të tjera të rrjetit dhe informacionit nga institucione tjera shtetërore; 2.6. dëshmitë se institucioni që parashtron kërkesën është pronar, ka në menaxhim dhe administron sistemin e informacionit dhe komunikimit; 2.7. pozitat e punës që dëshmojnë se institucioni ka përgjegjësi dhe administron me sistemin e informacionit dhe komunikimit; 2.8. emërtimin e pozitave kyçe që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit përkatës të informacionit dhe komunikimit, dhe propozimin për kategorizim të tyre sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik; 3. Institucioni i cili ka përgjegjësi për zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të sigurisë kibernetike dhe/apo TIK-ut në nivel shtetëror, duhet që në kërkesë të paraqesë edhe: 3.1. bazën ligjore që përcakton përgjegjësitë e institucionit për zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të sigurisë kibernetike dhe/apo TIK-ut në nivel shtetëror; 3.2. pozitat që kanë përgjegjësi zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të sigurisë kibernetike dhe TIK-ut në nivel shtetëror. Kërkesa sipas këtij neni, bëhet përmes plotësimit të formularit për identifikimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, i bashkëngjitur si Shtojcë 1 e kësaj Rregulloreje. Në rast se institucioni posedon më shumë se një (1) sistem, formulari duhet të plotësohet veçmas për secilin sistem.

-Nenit 6 Komisioni 1. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike, themelon Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike. 2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët caktohet kryesues, dhe janë përfaqësues të institucioneve si në vijim: 2.1. një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike; 2.2. një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Financa; 2.3. një (1) përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit. 3. Anëtarët e Komisionit emërohen me mandat tre (3) vjeçar. 4. Punën e Komisionit e udhëheq Kryesuesi i Komisionit. 5. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit, kur atyre iu kërkohet nga kryesuesi dhe të kryejnë punën me përgjegjësi dhe objektivitet.

07.08.2026

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 5 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, ku është përcaktuar se: *1. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit i cili vlerëson se institucioni është pronar, menaxhon dhe administron sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, ose koordinon funksionimin e këtyre sistemeve, parashtron kërkesë për vlerësim të sistemit tek Komisioni...*” dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji konstaton se kërkesat për vlerësim dhe përfshirje të sistemeve përkatëse si sisteme të rëndësisë strategjike, duke përfshirë edhe pozita e caktuar që janë të nevojshme për menaxhim dhe administrativ të këtyre sistemeve, parashtrohen vetëm nga Zyrtari Kryesor Administrative i institucionit gjegjes, andaj, mbi këto rrethana Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Për sa më sipër, e duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS*Lënda: A.nr.306/2026***Avdyll BEKETESHI**

*Procesmbajtës***Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit***Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit G.D;
- ZKM: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Personelit
- Arkivit të KPMSHCK-së.